



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1074/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e paraqitur nga Vjosa Rrahmani, kandidat për Kuvendin Komunal në Prishtinë, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht i bazuar apeli Anr.1074/2021, i datës 04.11.2021, paraqitur nga Vjosa Rrahmani, kandidat për Kuvendin Komunal në Prishtinë, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, me të cilin ka kërkuar rinumrimin në vendvotimet 1907E/01R 1906E/01R, 1911E/02R.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal të Prishtinës, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në Komunën e Prishtinës, në vendvotimet 1907E/01R 1906E/01R, 1911E/02R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Qendrat Votimeve, të vendosura si në pikën -II- të këtij dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet e pabazuar pjesa e apelit e paraqitur nga Vjosa Rrahmani, kandidat për Kuvendin Komunal në Prishtinë, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të

Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, me të cilin ka kërkuar rinumrimin në vendvotimin : 1911E/01R.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1074/2021 nga në të cilën pretendon se ka pasur parregullsi në vendvotimet 1906E/01R, 1911E/01R, 1911E/02R, 1907E/01R, pasi që në disa prej tyre kam marrë zero vota. Në apel ka bashkangjitur dy deklaratat të votuesve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Vjosa Rrahmani, kandidate për Kuvendin Komunal në Komunën e Prishtinës, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimet e lartcekura.

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket vendvotimeve, të vendosur si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, nga se rezulton se nga rezultatet përfundimtare të publikuara nga ana e KQZ-së në vendvotimin e 1906E/01R dhe 1907E/01R, 1911E/02R apeluasi ka gjithsej zero(0) vota, për secilin vendvotim, ndërsa si dëshmi në apel ka bashkangjitur për vendvotimin 1906E/01R, (1) një deklaratë, për vendvotimin 1907E/01R, (1) një deklaratë, 1911E/02R, (1) një deklaratë, të votuesve që dëshmojnë se e kanë votuar për kandidaten Vjosa Rrahmani, prandaj paneli konstaton se ka mospërputhje të rezultatit përfundimtar me deklaratat e votueseve andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për qendrat e votimit e si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi..

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës se

lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitim e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzues, të vendosur si në pikën -IV-, të dispozitivit paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, formular apo ndonjë deklaratë për vendvotimin 1911E/01R, lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.1074/2021 më datën 07.11.20



Kryesues i Panelit

Zyady Haziri

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.